

LIGJ
Nr.7373, datë 8.5.1990

PËR NDËRMARRJET

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ndërmarrja është njësia bazë e ekonomisë socialiste. Ajo ka për objekt prodhimin, shpërndarjen e qarkullimin e produkteve e të mallrave, si dhe ndërtimin e kryerjen e shërbimeve.

Ndërmarrja realizon marrëdhënie ekonomike socialiste me shtetin, me ndërmarrje të tjera, me institucione e kooperativa, si dhe me punonjësit e vet, sipas planit unik shtetëror.

Neni 2

Ndërmarrja është person juridik. Kolektivi i saj zhvillon veprimtari ekonomiko-prodhuese mbi bazën e mjeteve të prodhimit që ka në dispozicion, të cilat janë pronë shtetërore.

Ndërmarrja, si subjekt, për detyrimet përgjigjet vetëm me mjetet e saj.

Veprimtaria e ndërmarrjes zhvillohet e funksionon me llogari më vete.

Për produktin në natyrë marrëdhëniet e ndërmarrjes me shtetin si rregull, ndërtohen mbi bazën e detyrimit të saj për eksport dhe për shitjet jashtë rrethit. Ndërmarrja përgjigjet gjithashtu për të ardhurën neto të centralizuar të shtetit e për detyrimin ndaj buxhetit nga e ardhura e saj.

Neni 3

Drejtimi me llogari më vete sivuron harmonizimin e interesave të shtetit, si zotërues i mjeteve të prodhimit, me ato të kolektivit punonjës të ndërmarrjes, si përdorues i tyre. Pavarësia e ndërmarrjes i jep asaj këto të drejta:

- Të sigurojë, me fondet e veta riprodhimin e zgjeruar.
- Të përcaktojë vetë strukturën e prodhimit si rregull deri në 20 për qind të aftësive prodhuese të saj, që i lihen të pambuluara me plan. Në të njëjtën masë ndërmarrja i siguron vetë lëndët e para dhe shpërndarjen e produkteve të gatshme. Gjithashtu ajo disponon gjithë tepicën e prodhimit të cilën, në raste të veçanta, mund ta shesë edhe me çmime me pakicë.
- Kur janë mundësitë, ndërmarrja ka të drejtë që të hapë sektorë të rinj edhe jashtë profilit të saj për prodhimin e mallrave të përdorimit të gjerë ose për eksport.
- Të vendosë për strukturën organizative dhe për numrin e punonjësve, duke përfshirë edhe ata të disiplinuar me organikë, në përputhje me mundësitë që i jep fondi i pagave i limituar me plan. Ndërmarrja nuk mund të pakësojë numrin ekzistues të punonjësve, pa i sistemuar në një punë tjetër. Në rastin e tejkalimit të planit të prodhimit, të ndërtimit e të shërbimeve, ndërmarrjes i lind e drejta për fond page shtesë.
- Të vendosë për investimet për përmirësimin e kushteve të punës e të jetesës së punonjësve, si dhe për ato të shërbim të zgjerimit të prodhimit për objekte brenda limitit të saj.
- Të lidhë kontrata për furnizimin materialo-teknik dhe për shpërndarjen e produkteve.
- Të caktojë në marrëveshje me blerësit çmimet e shitjes së produkteve në emërtesë të saj.
- Të përfitojë e të porosisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, edhe importe suplementare, kur realizon ose tejkalon planin e eksportit.
- Të sigurojë pasurinë nga fatkeqësitë e natyrës dhe faktorë të tjerë kundrejt pagesës.

Neni 4

Ndërmarrja, me arkëtimet nga shitja e produkteve, nga punimet dhe shërbimet e kryera ose nga qarkullimi i mallrave, derdh në buxhet të ardhurën neto të centralizuar të shtetit, një pjesë të së ardhurës neto të saj si levë kontrolli për fondet themelore në përdorim, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave dhe detyrime të tjera.

Neni 5

Burimet e veta të të ardhurave ndërmarrja i përdor për financimin e riprodhimit të zgjeruar dhe për nevoja të tjera sipas kritereve që miraton Këshilli i Ministrave. Fondet e lira financiare ajo i depoziton në bankë dhe përfiton intersat. Llogaria më vete e ndërmarrjes trashëgohet.

Ndërmarrja, për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë ekonomiko-prodhuese, kur nuk i mjaftojnë mjetet e veta, hyn në marrëdhënie me bankën dhe ka të drejtë të marrë kredi afatgjatë për investime dhe kredi afatshkurtër për mjete zhiruese e nevoja të tjera, kundrejt interesave bankare.

Neni 6

Punonjësit e ndërmarrjes, punëtorët, personeli inxhiniero-teknik, ekonomik dhe drejtuesit, shpërblehen sipas normës, kategorisë së vendit të punës e atestimit, dhe në varësi nga rezultati ekonomik i njësisë përkatëse që punon me llogari më vete.

Punonjësit kanë pjesën e tyre në të ardhurën neto të ndërmarrjes.

Kur ndërmarrja e planifikon me rritje të ardhurën neto të saj ndaj faktit të një viti më parë dhe e realizon ose e tejkalon atë, punonjësve u lind e drejta të përdorin për shpërblim deri në gjysmën e diferencës midis dy periudhave. Të ardhurat që përfiton punonjësi nga ky fond mund të llogariten deri në tri paga mujore në vit. Kolektivi ka të drejtë të vendosë për masën e shpërblimit ose të rezervimit të këtij fondi për garantimin e pagave dhe qëllime të tjera.

Në ndërmarrjen që i caktohet një plan më i vogël se fakti i periudhës së mëparshme për të ardhurën neto të saj, punonjësit kanë të drejtë të përfutijnë sipas rregullit të mësipërm vetëm për tejkalimin.

Kur e ardhura neto e ndërmarrjes nuk realizohet, punonjësit do ta përballojnë deficitin nga paga e tyre, me kusht që ndalesa të mos jetë më shumë se 10 për qind e pagës së llogaritur të tyre.

Ndërmarrjet e planifikuara me humbje, për rastet e pakësimit ose të tejkalimit të humbjes, gëzojnë të drejtë dhe detyrime analoge.

Ndërmarrja nga e ardhura neto që siguron, krijon edhe fonde për të stimuluar materialisht novatorët e racionalizatorët, punonjësit e dalluar, si dhe për qëllime të tjera në dobi të kolektivit e të punonjësve.

Neni 7

Ndërmarrja ka për detyrë të plotësojë planin ekonomik e financiar, si dhe të shlyejë detyrimet ndaj punonjësve të saj, ndaj buxhetit të shtetit, sigurimeve shoqërore dhe bankës, detyrimet kontraktore, vlefshme të mallrave të punimeve e të shërbimeve të kryera nga të tretët, si dhe detyrime të tjera.

Neni 8

Humbjet e planifikuara i mbulohen ndërmarrjes me donacion shtetëror, që jepet për njësi prodhimi. Humbja jashtë planit vitin e parë mbulohet nga banka me kredi afatshkurtër me interesa më të larta. Në rast të përsëritjes së humbjeve të paplanifikuara, mund të arrihet deri në këto masa: pushim nga puna e personelit drejtues-administrativ, inxhiniero-teknik e ekonomik dhe zëvendësimi i tij, transferim i vepmtarisë prodhuese ose ndërprerje të saj. Shteti në këtë rast merr përsipër sistemimin në punë të punonjësve.

Neni 9

Krijimi i ndërmarrjeve të reja bëhet me vendim të Kryesisë së Këshillit të Ministrave.

Bashkimi dhe ndarja e ndërmarrjeve ekzistuese bëhet me aprovimin e ministrit ose të drejtuesit të institucionit tjetër qendror, mbi bazën e propozimit të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Kur krijimi, bashkimi dhe ndarja e ndërmarrjeve, si dhe shkëputja e një pjese të veprimtarisë së tyre lidhet me kalimin administrativ të pasurisë së kooperativave bujqësore në pronë shtetërore ose anasjelltas, vendimi merret nga Kryesia e Këshillit të Ministrave, por pasi të jetë dhënë më parë pëlqimi i mbledhjes së përgjithshme ose i përfaqësuesve të kooperativës bujqësore.

Neni 10

Ndërmarrjet kanë vartësi administrativo-ekonomike nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve ose nga ministritë e insitucionet e tjera qendrore. Këto kanë të drejtë dhe detyrë të kontrollojnë e ndihmojnë të gjitha ndërmarrjet e sitemit apo territorit të tyre.

Neni 11

Akti për krijimin, ndarjen ose bashkimin e ndërmarrjes duhet të përmbajë:

- a) Emrin e ndërmarrjes, të plotë e të shkurtuar, si dhe qendrën e saj.
- b) Objektin e veprimtarisë themelore.
- c) Mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros që i jepen ose mënyrën e sigurimit të tyre.
- ç) Ministrinë ose institucionin tjetër qendror, në sistemin e të cilit do të bëjë pjesë.

Neni 12

Njësitë ekonomike që funksionojnë me bilanc të brendshëm më vete miratohen nga vetë ndërmarrjet që i kanë në përbërje. Për ato njësi që do të kenë llogari likuiduese, merret edhe pëlqimi i bankës në rreth.

Neni 13

Pasuria e ndërmarrjes përbëhet nga mjetet kryesore dhe mjetet e xhiros.

Ndërmarrja ka të drejtën e nëdorësisë e të shfrytëzimit të mjeteve kryesore, si dhe të drejtën e disponimit të mjeteve të xhiros.

Neni 14

Veprimtaria e ndërmarrjes organizohet, drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili zgjidhet nga kolektivi punonjës dhe jep llogari para tij. Drejtori mban përgjegjësi për gjithë veprimtarinë e ndërmarrjes. Kolektivi punonjës ka të drejtë të shkarkojë atë, si dhe kuadrot e tjerë, kur nuk u përgjigjen detyrave që u janë ngarkuar, duke njoftuar, sipas rregullave organet përkatëse.

Neni 15

Në ndërmarrje krijohet këshilli tekniko-ekonomik, si organ këshillimor i drejtorit, që përbëhet nga punonjës pararojë e specialistë të aftë.

Këshilli tekniko-ekonomik shqyrton probleme që lidhen me rritjen e prodhimit, me përmirësimin e cilësisë e progresit, teknik, me rritjen e efektivitetit dhe zhvillimin perspektiv të ndërmarrjes etj. Ai rekomandon masa për përmirësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të ndërmarrjes.

Përbërja e këshillit tekniko-ekonomik caktohet nga drejtori i ndërmarrjes.

Neni 16

Për ruajtjen e administrimin e pronës socialiste dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën e prodhimit, të shpërndarjes të pagave dhe të treguesve të tjerë teknikë, ekonomikë e financiarë, në ndërmarrje dhe në njësitë ekonomike brenda saj organizohet dhe funksionon kontroll i brendshëm i cili ushtrohet nga të gjitha hallkat e strukturës organizative të saj. Veprimtaria e ndërmarrjes kontrollohet e ndihmohet edhe nga organet e specializuara të kontrollit shtetëror.

Neni 17

Hartimi i planit ekonomik e financiar në ndërmarrje, mbajtja e kontabilitetit dhe administrimi i pronës, mbështetur në metodologjinë e planifikimit të ekonomisë socialiste dhe në rregullat që caktohen me dispozita të veçanta.

Neni 18

Ndërmarrja organizon shërbimin statistikor. Ajo mban përgjegjësi për saktësinë dhe paraqitjen në kohë të treguesve që raporton pavarësisht nëse përmban ose jo në plan.

Neni 19

Ndryshimi i kompetencave dhe i treguesve që rregullojnë marrëdhëniet ekonomike e financiare të ndërmarrjeve me shtetin, bëhen nga Këshilli i Ministrave ose organet e autorizuar prej tij.

Neni 20

Në mbështetje të këtij ligji, ndërmarrja, për organizimin e brendshëm, harton rregulloren e saj.

Neni 21

Dekreti nr.4850, datë 12.6.1971 “Për ndërmarrjet”, shfuqizohet.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1991.

SEKRETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA